



REPUBLIKA E KOSOVËS • REPUBLIKA KOSOVA • REPUBLIC OF KOSOVO

KOMUNA E FERIZAJT • OPŠTINA UROŠEVAC • MUNICIPALITY OF FERIZAJ



<http://kk.rks-gov.net/ferizaj>

### Procesverbal 04/2024

I Mbajtur në takimin e IV-të të rregullt të KK-së me datën 30.04.2024, në sallën e Kuvendit në ora 10:00 nën kryesimin e Kryesuesit të KK-së, Xhavit Zariqi, në prani të anëtarëve të saj, OJQ-ve dhe Zyrtares për informim.

#### Fjalën Hyrëse – Kryesuesi të KK-së, Xhavit Zariqi;

Përsëndetje për të gjithë të pranishmit, drejtor/e, media dhe shoqëri civile, të nderuar dhe të respektuar Anëtarë të Kuvendit të Komunës së Ferizajt. Po fillojmë me mbledhjen e IV-të të rregullt të Kuvendit të Komunës së Ferizajt dhe për këtë mbledhje në bazë të materialit që e keni marr propozoj këtë rend dite:

#### Rendi i ditës:

1. Konfirmimi i pjesëmarrjes në mbledhjen e KK-së;
2. Miratimi i rendit të ditës;
3. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes të kaluar të KK-së;
4. Propozim -Vendim për Themelimin e Forumit të Panelit për Transparencë Komunale për Kuvendin e Komunës së Ferizajt;
5. Propozim - Vendim për daljen në Diskutim publik të Statutit aktual të QKMF-së të Vitit 2016 si dhe Draft-Statutin Unik të QKMF-së të adaptuar me specifika të QKMF-së Ferizaj;
6. Raporti financiar për periudhën Janar-Mars 2024
7. Pyetje dhe kërkesa dhe
8. Të ndryshme.

#### Pika Shtesë

##### 1.Propozim – Vendim për bartjen e mjeteve THV nga Viti 2023 në Vitin 2024

**Kryesuesi** pyeti nëse ka dikush diçka për të shtuar dhe fjalën e morri Elbasan Osmani i cili theksoi se propozoj të futet edhe një pikë e rendit të ditës, ma konkretisht njoftimin rreth përzgjedhjes së Kryetarëve të fshatrave është një proces që ka filluar në nëntor dhe tani jemi në muajin prill edhe më kërkesë edhe të atyre që janë zgjedh duhet ta dimë çka ka ndodhë me këtë proces, pasi janë mbetur edhe 3 fshatra pa u zgjedh.

**Brahim Osmani** pasi falënderoi të pranishmit në mbështetje të nenit 47 të Ligjit për vetëqeverisjen lokale kërkojmë që në këtë rend të ditës të shtohet edhe pika për gjendjen me mbeturina në Qytetin e Ferizajt, meqenëse situata me mbeturina është urgjente dhe ka rëndësi të lartë publike sepse i prek të gjithë qytetarët e komunës sonë që i banjë pasojat e kësaj gjendje të renduar, argument është edhe vendimi i kryetarit Aliu duke shpallur gjendje të jashtëzakonshme, i ftoj edhe koleget nga kuvendi që ta përkrahin këtë pikë, pasi që edhe vet Kryetari Aliu ka thënë që është një gjendje emergjente.

Për të gjithë qytetarët kjo është gjendje emergjente dhe më kanë treguar ku besoj edhe juve ju kanë kontaktuar dhe ju kanë shprehur shqetësimet e tyre për këtë gjendje.

Edhe njëherë kërkoj që të kemi mbështetjen e të gjithëve për këtë pikë të rendit të ditës.

Kryesuesi i Kuvendit e hodhi në votim rendin e ditës të propozuar në KPF me pikën shtesë dhe kaloi.

**Kryesuesi i Kuvendit** e hodhi në votim pikën e rendit të propozuar nga Elbasan Osmani dhe kaloi me 23 vota për, 0 kundër dhe 4 abstenim, pra hyn në rend të ditës.

**Kryesuesi** pyeti se kush është për çështjen e mbeturinave që të diskutohet, pra propozimi i Brahim Osmanit dhe kjo pikë kaloi me 18 vota për, 15 kundër dhe 0 abstenim.

**Kryesuesi** pyeti se nëse ka dikush diçka rreth procesverbalit pra pikën e 3-të dhe pasi nuk pati vërejtje kaloi me të gjitha votat për.

**Kryesuesi** e lexoi pikën e 4-të pra formimin e panelit për transparencë komunale ku u propozua nga një anëtar nga secili grup parlamentar dhe ku PDK e propozoi Arbnora Salihu, nga VV u propozua Adnan Selmani, nga LDK u propozua Besim Haziri dhe nga AAK u propozua Zekir Bytyqi dhe kjo përbërje kaloi me vota unanime.

**Kryesuesi** e lexoi pikën e 5 dhe ia kaloi fjalën Drejtorit Kemajl Emini i cili pasi përshëndeti të pranishmit theksoi se në bashkëbisedim me Ministrin e shëndetësisë na është kërkuar që të bëjmë një Statut unik dhe duhet të theksojmë se e mira e kësaj është që ky statut është për momentin vetëm në dalje të konsultimit publik, e di që nuk është profesional ose me mirë me thënë kemi vërejtje, unë vet kam vërejtje dhe do t'i paraqes vetë ato, andaj ju ftoj që edhe mjek e profesionist të fushës të vijnë dhe të paraqesin opinionet e tyre, më lejoni që të bëjë edhe një njoftim, ku me 14 Qershor është dita për dhurimin e gjakut dhe ju ftoj që ata që kanë mundësi ta bëjnë këtë gjest human, pasi që kjo sasi e gjakut do të dhurohet për Spitalin e Ferizajt, ku dimë se ky spital mbulon mbi 300 mijë banorë, faleminderit.

**Kryesuesi** pyeti nëse ka dikush diçka lidhur me këtë pikë dhe fjalën e mori Flamur Istrefi i cili theksoi më nxiti fjalimi i drejtorit ku tha se koleget që janë staf shëndetësor duhet të vijnë të japin vërejtje ku i njëjti rast ka ndodhë me kuvendaret, e kemi dhënë mendimin vitin e kaluar dhe nuk besoj që do të ketë ndonjë ndryshim, shqyrtimi publik ka me u mbajt veç sa për sy e faqe

dhe pres që kjo mos të kaloj kështu si është, vetëm nëse ka indikator që kjo çështje mund të ndryshoj.

**Arian Imeri** pasi përshëndeti të pranishmit theksoi se realisht unë e mirëkuptoj çdo propozim kur mendon që është tu e dhanë ma të mirën për këtë çështje mirëpo duhet me pas parasysh që ne jemi përfaqësues lokal të qytetarëve dhe normalisht disa nga propozimet tona pra nuk mund të kenë fuqi që të ndryshohet pasi që deputetet kanë fuqi më të madhe dhe normalisht kjo çështje duhet të shihet në këtë formë dhe çdo ndryshim pozitiv duhet të përkrahet sado i vogël që mund të jetë, ne kemi miratuar edhe statute tjera p.sh. atë të teatrit dhe normalisht nuk kanë qenë të kënaqur të gjithë edhe me atë mirëpo duhet pasur parasysh që ne mund të bëjmë ndryshime brenda kornizave ligjore, faleminderit.

**Ibrahim Hyseni** pasi përshëndeti të pranishmit theksoi se unë edhe pse s'jam profesionist i fushës, e kam lexu me përjashtim të nenit 14 ku kandidati për drejtor të jetë mjek familjar, unë se di a është caktu nga ministria kjo, apo është caktua këtu kështu, le të ju jepet mundësia edhe mjekëve tjerë.

**Kemajl Emini** edhe mendimi jem është që tu ju ipet mundësia edhe profesionistëve të tjerë të fushave të ndryshme, mirëpo është qëndrim i ministrisë që të jetë mjek familjar.

**Shqipe Jashari** pasi përshëndeti të pranishmit e pash një pikë aty heqja e infermierëve me drejtimin e mamisë, e kuptoj që kanë të drejtë, mirëpo kemi edhe infermier me drejtimin e pediatriisë dhe ku realisht ka në QKMF, me këto dy drejtime a do të largoni këto prej punës dhe këto të pediatriisë, a janë paraparë në Statut a jo.

**Kemajl Emini** të gjithë ata punëtorë që janë në punë do të vazhdojnë deri në pensionim dhe çdo gjë që e parasheh Statuti normalisht vijon nga momenti i hyrjes në fuqi, këto sene i dinë edhe t'i Shqipe mirë, po nganjëherë po keni qef ma shumë me u pa se me u duk.

**Shqipe Jashari** drejtor unë kërkoja sqarim për punëtorët e CARITAS-it çka keni me ba? Kjo ishte pyetja.

**Kryesuesi** pasi nuk ka të tjerë për diskutim atëherë unë e propozoj që të hudhet në votim dhe kjo pikë kaloi me 34 vota për, 0 kundër, 0 abstenim.

**Kryesuesi** e lexoi pikën e 6 pra Raporti financiar për periudhën Janar-Mars 2024 dhe ia kaloi fjalën Drejtores së Financave, e cila pasi përshëndeti të pranishmit theksoi se duke u bazuar në ligjet në fuqi, lidhur me raportet financiare, kemi paraqitur këtë Raport financiar për periudhën kohore Janar-Mars 2024 dhe të shpërndarë në tabela e keni te detajuar dhe nëse dikush ka diçka të pa qartë për të pyetur urdhëroni.

**Kryesuesi** e lexoi pikën e 7 dhe ia kaloi fjalën Drejtores së financave e cila theksoi se paraprakisht me duhet të ju njoftoj që ka një ndryshim nga KPF ku e keni pranuar me kohë, pasi në pjesën tabelore është një ndryshim ku kemi futur një projekt kapital, përpos këtij projekti

kapital pjesa tjetër është e paraqitur në formë tabelare, pra aty i keni të vendosur edhe kodet dhe shumat e sakta se sa janë të ndara në ato kategori.

**Sylejman Metushi** te shpërndarja e këtyre mjeteve p.sh. te administrata e shëndetësisë janë një shumë e konsiderueshme ku janë nda për kancer, kjo gjë është shumë e mirë, mirëpo unë po flas nga praktika ku aty në spital shpesh herë as letër mi pastru duart nuk ka, mirë do kishte me qenë që disa gjëra elementare bazike p.sh. të higjienës do të duhej të intervenohet pasi po lëmë një pasqyrë tejet të keqe me gjëra të imta.

**Kryesuesi** pasi spati të interesuar për debat e hodhi në votim këtë pikë dhe kaloi me 34 vota për, 0 kundër dhe 0 abstenim.

**Kryesuesi** theksoi se vazhdojmë me raportin për zgjedhjen e Kryetarëve të fshatrave, pika e 8-të me rend dhe e ftoj propozuesin që të paraqes, Elbasan Osmani realisht kanë mbetë disa kryetar pa u zgjedh pra janë ba mbi 4 muaj dhe kryetarët e tjerë që janë zgjedh kanë mbetë pa u legjitimua, normalisht ata që janë zgjedh kanë kërkesa dhe nevoja dhe një kohë kaq e gjatë, nga informacionet që kam një anëtar nga komisioni ka kalu në KPF dhe ai do të duhet që të ipte dorëheqje për të vazhduar tutje, komisioni është miratua nga kuvendi dhe ata do të duhej t'i japin përgjegjësi kuvendit dhe kjo çështje do të duhet të zgjidhet.

**Brahim Osmani** kolegu duhet ta dijë që nuk ka të bëjë me një anëtar të komisionit, pasi ne kemi ba një plan të punës, ndërsa plani i punës është devijua me urdhërin e Kryetarit Aliu, ku është tejkalu nga 40 në 43, duhet ta keni parasysh një gjë që unë edhe mund të zëvendësohem me një anëtar edhe me ata anëtarët tjerë, pa mua aty do të bëhet votim, mund të ecet procesi përpara, mirëpo i keni rritë numrin në 43 dhe i keni mashtrua fshatrat dhe në këtë formë do të shkelet udhëzimi administrativ dhe normalisht do të kthehet vendimi si i pa ligjshëm, nuk o mirë me bo propagandë nëpër fshatra me ju thanë që anëtari nga VV e ka blloku procesin.

**Elbasan Osmani** në rregull pse kolegë nuk e ofroni dorëheqjen për të mos e penguar atë proces, pse po vazhdoni të komunikoni me ato fshatra, urdhëroni mbasi po mund të jepni dorëheqje, urdhëroni ofrojeni këtë dhe të vazhdohet, të mos pengohet ky proces.

**Brahim Osmani** LVV nuk e shkel ligjin, i keni gënjye banorët e fshatrave, mu qytetarët më kanë pru këtu me u sqarua mirë me Kryetarin e komunës, me Nënkryetarin e komunës, me Kryetarin e komisionit, ju mundeni edhe pa dy anëtarët e opozitës të procedohet puna, mirëpo s'keni me mujt.

**Flamur Istrefi** për hirë të së vërtetës nuk është blloku për shkak të anëtarit të LVV por është blloku për shkak të limitit të nr. të anëtareve, pra keni premtua shumë, duke hapur zona të reja, pra shumicën e votave e keni, urdhëroni zgjidheni dhe bjereni Raportin këtu.

**Kryesuesi** kalojmë në pikën e 9-të dhe ftoj Brahim Osmanin që të paraqes këtë pikë, i cili theksoi se gjendja në komunën tonë është alarmante për shkak të mbeturinave, nuk është vetëm në këtë vit mirëpo në komplet çështjen e Kryetarit Aliu, kjo çështje është bërlllok, pra Ferizaji

është shndërrua në një deponi të bërlllokut, mirëpo kjo është vetëm një arsye apo formë, mirëpo kjo procedurë është për të falimentuar ndërmarrjen dhe për t'i ofruar tender të tillë për të afërm të kryetarit, punëtorëve ju janë premtuar paga të rritura, mirëpo që s'ka ndodhur edhe ato që janë rritur janë vetëm për menaxhmentin, e leje më për trustin e shpenzimet enorme, këtë ndërmarrje partit e pushtetit e kanë përdorur vetëm për të punësuar militant partiak, të gjithë e dimë që aty keqpërdorimet janë tejet të mëdha dhe asnjëherë aksionarët nuk kanë ardhë me i raportua këtij kuvendi, madje këtu s'është as Drejtori i shërbimeve i cili prej sharjes këtu ka qenë veç kur kryetari ka qenë në seancë, dhe menjëherë pas kësaj seance do ta thirrim seancën e jashtëzakonshme për shkarkimin e aksionarëve.

**Verona Isaku** pasi përshëndeti të pranishmit, fillimisht është e papranueshme që asamblistët e PDK-së se votun këtë pikë, për tu diskutu duke patur parasysh gjendjen dhe normalisht me gjasë Kryetari Aliu po jeton një botë paralele dhe nuk po e shehë këtë realitet, ne para një e dy viteve kemi thënë që po shkatërrohet kjo kompani, po falimentohet për të marrë tender të afërm të pushtetit, ato dy tri kompani.

Një çështje tjetër që duhet të merren organet ku edhe unë nga kjo foltore i ftoj që të hetojnë, është çështja e kryeshefit të kësaj ndërmarrje, i cili po dyshohet që i ka kërcënua punëtorët e kësaj ndërmarrje në forma të ndryshme, po ashtu një shqetësim tjetër është edhe me Drejtorin e shërbimeve publike i cili gënjej publikisht, e fyen publikisht me sharje në seanca, ku nga televizioni kemi parë që vetëm rreth 5 euro ka ngritje të pagave, e ajo pagë nuk mund të quhet rritje, falemindedrit.

**Amir Rexhepi** pasi përshëndeti të pranishmit theksoi se tani më kemi hyrë në javën e 2-të të grevës dhe jo veç emergjente por duhet të shpallet gjendje e jashtëzakonshme dhe tani na është shfaqur edhe një rrezik tjetër nga qentë endacak, pasi ata shkojnë te bërllloku dhe normalisht ata qenë rrezikojnë me jetë fëmijët të cilët shkojnë nëpër shkolla dhe kush do të jepte përgjegjësi për këtë çështje dhe unë propozoj që këta aksionar të shkarkohen në mënyrë që të bëhet një zgjidhje për këtë problem, që po na përcjellë tash e sa kohë.

**Arian Imeri** ne në parim jemi pro diskutimit të kësaj gjendje, mirëpo ne po diskutojmë për një situatë të kompanisë për brenda ku duhet ata vetë të bëjnë zgjidhje, dhe kërkesat e punëtorëve për rritje pagash dhe nga shkresat zyrtare paraqitet një situatë ku menagjmenti aty paraqet të dhëna, që ajo çështje ka ndodhur dhe aty normalisht që ka probleme të brendshme, por një gjë duhet të dihet që ajo kompani ka organe, ka bord, ka menagjment dhe ata janë zot shtëpie aty dhe normalisht unë isha kundër që të diskutohet kjo çështje pasi që ne nuk kemi informacione të hollësishme për ta diskutuar këtë çështje, ne këtu kemi kompetenca vetëm nga bordi i aksionarëve dhe ne do të duhej të kërkojmë një raport fillimisht, e më pas të shikohet çka mund të bëjmë.

**Flamur Istrefi** sa i përket Pastërtisë kemi diskutua disa herë, dola për shkak të Arianit, ku tha bordi i aksionarëve është Komisioni i aksionarëve, ku tha duhet të paraqitet raporti dhe ne kemi një bilanc negativ, me miliona euro dhe normalisht do të duhet të sjellin raport, do të duhej të

kishte një zingjir të shkarkimeve nga Kryeshefi e te poshtë, ne si LDK i kemi dhanë nënshkrimet për organizimin e mbledhjes së jashtëzakonshme për shkarkimin e anëtarëve të Komisionit të aksionarëve, mos puna e tyre na ka prurë në këtë ditë, kolegja tha që kryetari o tu jetu në jetë imagjinare, botë paralele për ditë vrasje probleme bërlllok si këto foto këtu përpara,

**Kryesuesi i Kuvendit** theksoi se Flamur nuk është mirë me u marrë me spekulime, pasi kryetari nuk është duke u marrë me botë imagjinare, pasi që kryetari ka shpallur gjendje të jashtëzakonshme, ai sipas mendimit tim është tu marrë me probleme reale.

Pse spekulon që gjendja financiare është përkeqësua, kur është e kundërta për çdo vit ajo është rregullu.

**Kryesuesi**, kush nuk ka folë për këtë temë, mund ta merr fjalën, ndërsa ata që kanë folë ka përfunduar debati për këtë temë.

**Sadat Ismajli** pasi përshëndeti të pranishmit theksoi se paga e punëtorit fizik ish dikun 450 euro pa mëditje, ndërsa paga e punëtorëve, vozitësve është dikun 490 pa mëditje d.m.th. unë e kam një kërkesë të veçantë, këtu ka asambleist që ka obligim mbi 200 euro, andaj ju ftoj që të shkoni ta paguni.

**Besim Haziri** pasi përshëndeti të pranishmit theksoi se ne jemi politikan dhe duhet të diskutojmë, neve na intereson kush është përgjegjës për këtë punë dhe unë mendoj që kryetari është përgjegjës dhe kryetari ka thanë që e bëjë Ferizajin Europjan, ndërsa ky qytet u shëndrru në qytet të mbeturinave dhe vend i qenve endacak.

Hjeki qent, hjeke bërlllogun edhe në rregull jemi.

**Amir Rexhepi** pasi përshëndeti të pranishmit, Kryesues u përmend që janë rrit 3 herë pagat veç tregona sa janë rrit ta dimë edhe na pasi jem Anëtar të kuvendit Kryesues a janë marrë naj mas ndaj tyre, nëse janë të pa përgjegjshëm s'banë na me pësu, nëse dikujt ju ka tek me organizu protesta.


**Elbasan Osmani** në fakt në momentin e propozimit unë isha kundër kësaj pike për shkak se institucionet komunale janë duke e trajtu, këtë temë e ki postimin e fundit që janë angazhu ekipe shtesë dhe këto foto me siguri janë të vjetra, dhe e kuptoj që ju duhet me kriju tema edhe nëse masat janë marrë një hap mbrapa që me trajtu tema, mirëpo një gjë duhet me kuptu që ata punëtorë janë të nxitur si e tha edhe kryesuesi, por masat janë marrë dhe do të mirën ndaj tyre.

**Shqipe Jashari** pasi përshëndeti të pranishmit, theksoi se kolegu po thotë që janë tu mbledhë mbeturinat, mirëpo nuk është e vërtetë pasi që veç në "Vezir Jashari" sa ka mbeturina, ndoshta sa gjysma qytetit kanë fillu, ndoshta ekipe mobile p.sh. në vende të caktume p.sh. te spitali për shkak të mos përhapjes së pandemisë, apo diçka e tillë, mirëpo kjo gjendje është në teren, këto foto janë reale, mirëpo nëse dilni në këmbë o rrezik prej qenve endacak, mos u mundoni me na hedhë hi syve, pasi që gjendja o për me i shkarkuar këta anëtar të bordit.

**Kryesuesi i Kuvendit me kaq e mbylli debatin për këtë temë.**


A ka diçka në pyetje dhe kërkesa, nëse nuk ka kalojmë në pikën në të ndryshme pasi edhe këtu nuk ka kërkuar kurgja, me kaq e shpalli të mbyllur mbledhjen e 4-të të rregullt të Kuvendit të Komunës së Ferizajt.

**Procesmbajtësi**



**Leutrim Mahmuti**

**Kryesuesi i Kuvendit të Komunës**



**Xhavit Zariqi**

